

V E N D I M
Nr. 10, datë 2.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Zija Vuci,	Anëtar i	“	“
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“	“
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori,	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto,	Anëtar i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.241/7 Akti që i përket:

KËRKUES: LULEZIM MURTHI, përfaqësuar nga avokate Valbona Kotorri, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: HAMDI, LIRI, HASAN E DHURATA FAJA, përfaqësuar nga Hamdi Faja, me deklaram.

BESIM, METIE, MYRTEZA, HAXHIRE, XHELAL, DILE E IRMA MURTHI, SI DHE YLLKA YLLI, MAJLINDA BEGA, ILIRJAN SPAHIU E VJOLLCA MUZHAQI, në mungesë.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.1050, datë 26.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr.73, datë 26.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore:

- Nuk është thirrur në gjykimin e pjesëtimit të pasurisë, megjithëse është bashkëpronar;
- Dëshmia e trashëgimisë ku është bazuar gjykata është deklaruar e pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Legjitimiteti t'i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim, sepse subjektet e interesuara kanë fshehur provat në gjykimin në gjykatën e rrethit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuessve, subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, ka pranuar kërkesën e paditësve Hamdi, Liri, Hasan e Dhurata Faja ngritur kundër të paditurve Besim, Metie, Myrteza, Haxhire, Xhelal, Dile e Irma Murthi; Yllka Ylli, Majlinda Bega, Ilirjan Spahiu e Vjollca Muzhaqi dhe ka lejuar pjesëtimin e tre trojeve duke caktuar pjesën ideale të secilës palë pjesëmarrëse në gjyq.

Nga materialet e çështjes rezulton se ajo gjykatë nuk ka thirrur si palë në gjyq dhe nuk i ka caktuar pjesë kërkuessit Lulëzim Murthi, sepse është bazuar në dëshminë e trashëgimisë nr.1802, datë 18.10.1993 të lëshuar nga zyra noteriale Tiranë, në të cilën kërkuessi nuk figuronte si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit Maliq Murthi dhe në dokumentet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në të cilat kërkuessi nuk ishte i regjistruar si bashkëpronar në kohën e zhvillimit të gjykimit.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë duke paraqitur si provë vendimin nr.26, datë 16.11.1956, me të cilin

trashëgimlënësi Maliq Muthi, është njohur si i ati i tij. Ai ka paraqitur gjithashtu kopje të vendimit nr.2224, datë 3.6.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë, me të cilën është deklaruar si e pavlefshme dëshmia e trashëgimisë me nr.1802, datë 18.10.1993 për pjesën e trashëgimtarëve ligjorë të Maliq Murthit, duke përcaktuar si të tillë edhe kërkuësin. Megjithatë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.73, datë 26.7.2002 nuk ia ka pranuar kërkesën me arsyetimin se kërkuësi nuk legjitimohet të kundërshtojë atë vendim, përderisa nuk ka qenë palë në gjykim.

Kërkuësi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues. Nga vendimi i gjykatës së rrethit dhe nga ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, del se kërkuësi nuk ka qenë palë në gjykimin në gjykatën e rrethit, në të cilën pretendon se i është mohuar bashkëpronësia dhe sipas parimeve procedurale, ai vendim nuk mund të ketë efekte juridike për kërkuësin. Si rrjedhojë, këtij të fundit nuk i është mohuar e drejta të ngrejë padi themeli në gjykatë për çdo mohim të së drejtës së tij të bashkëpronësisë.

Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë gjykatë, vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve.

Veç sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, nuk mund të mos vërë në dukje që procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat është i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Fakti që provat e reja të paraqitura pas gjykimit dëshmojnë se kërkuësi është bashkëpronar në pasurinë trashëgimore nuk mund ta bëjnë procesin të parregullt, përderisa nuk del që gjykatat të kenë neglizhuar si për marrjen e provave, ashtu edhe për thirrjen në gjyq të personave që pretendojnë për bashkëpronësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.